

## POP 2019

“Përballja e Ofertave Politike – POP 2019” e organizuar nga 11 organizata të shoqërisë civile të mbështetura nga Olof Palme International Centre dhe Ambasada e Suedisë në Shqipëri, vjen gjatë proceseve elektorale për të katërtin herë rradhazi, si një mundësi për qytetarët shqiptarë që nëpërmjet debatit publik të informohen mbi platformat elektorale të partive dhe kandidatëve për kryetarë bashkie, duke krijuar të gjithë hapësirat e nevojshme që prioritetet e qytetarëve të bëhen pjesë e alternativës qeverisëse.

# Përballja e Ofertave Politike MAJ 2019

Me synimin e marrjes së mendimit qytetar në periudhën Mars-Prill 2019, në territorin e Bashkive: Durrës, Fier, Kamëz, Kukës, Pogradec, Pukë, Shkodër, Tiranë, Vlorë u organizuan forume me përfaqësues të komunitetit, banorë të qytetit dhe të njësive administrative. Në takime morën pjesë burra, gra, vajza dhe djem dhe grupe të marginalizuara. Me anë të sistemit të pikëzimit, ata vlerësuan performancën e Bashkisë, identifikuan nevojat dhe prioritetet e qytetarëve. Në këto Forume u diskutuan 25 çështje që u përkasin katër fushave kryesore që ndikojnë drejtpërdrejtë mbi komunitetin vendor: Shërbimet publike; Zhvillimi ekonomik vendor; Dimensioni social dhe Demokracia vendore.

---

*Kliko*



# FOKUS GRUPET


mars - prill 2019

Në kuadër të organizimit të POP 2019 “Përballja e Ofertave Politike” u organizuan 53 forume me qytetarët në 9 bashki pjesëmarrëse në këtë projekt. 25 forume u organizuan në njësitë administrative rurale 28 forume u organizuan në njësitë administrative urbane.


1112 Pjesëmarrës ishte numri total i qytetarëve që iu bashkuan forumeve në të gjitha bashkitë pjesëmarrëse. 693 GRA dhe 419 BURRA.

Mbi bazën e vlerësimit të vetë pjesëmarrësve prioritetet e identifikuar nga komuniteti u organizuan në tre grupe: 1. Ndërhyrje prioritare, ku përfshihen çështjet që në këndvështrimin e komunitetit janë shumë të rëndësishme për ta dhe kërkojnë më shumë angazhim në vijim nga të zgjedhurit vendorë; 2. Ndërhyrje disi prioritare, që përfshijnë ato çështje që janë më pak të rëndësishme krahasuar me grupin e parë; 3. Vijueshmëria përfshin çështje të cilat kanë arritur zhvillimin e pritshëm nga komuniteti dhe për to nevojitet vetëm ruajtje e të njëjtit standart nga të zgjedhurit vendorë.


NUMRI I FORUMEVE SIPAS BASHKIVE



FORUMET SIPAS ZONAVE



PJESËMARRJA SIPAS GJINIVE



# KONTRATAT SOCIALE



-  Durrës
-  Fier
-  Kamëz
-  Kukës
-  Pogradec
-  Pukë
-  Shkodër
-  Tiranë
-  Vlorë

 *Klikoni bashkinë tuaj për të lexuar Kontratën Sociale.*